



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:052797

Datë: 01.04.2019

Numri i dokumentit: 00263468

P.nr.175/2018

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me Sek. Juridike Vjollca Bytyqi, ne lenden penale PP.II.nr 211-10/2018 të datës 28.03.2018, ndaj të pandehurit I G nga Suhareka, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 i Kodit Penal, në prezencë të prokurorit të PTH-së nga Prizreni Beqë Shala dhe të akuzuarit, në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me dt.28.03.2019 mori publikisht dhe shpalli me date 01.04.2019 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari I G i lindur më, i biri i S G dhe nënës N G, e gjinisë M, nga fsh. L, jeton ne Suhareke, rr. “J K” pa numër, me numër, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

ESHTE FAJTOR

Sepse me dt. 31.12.2017 rreth orës 06;30 ne Prizren ne fshatin Sh Komuna e Suharekës saktësisht ne udhëkryqin te Zona Industriale, duke drejtuar automjetin e tij te tipit Renault Espase, me ngjyre te gjelbër, me targa 01-...-BD, i cili ishte ne lëvizje re relacionin Suharekë – Prizren, vepron ne kundërshtim me nenin 50 (3) te ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, ashtu qe nga pakujdesia lëshon shiritin e tij te lëvizjes te mjeteve nga kahu i kundërt, ne atë mënyrë qe ne pjesën ballore godet ne pjesën ballore veturën Mercedes Benz 310, ngjyre e kaltër me targa 04-....-EF i cili lëvizë ne drejtimin Prizren Suharekë te cilin e drejtonte i dëmtuari B K, nga fsh. S komuna e Suharekës ku si pasoje e aksidentit te dy veturat e përfshira ne aksident pësojnë dëmtime materiale kurse lëndime te lehta trupore pësojnë te dëmtuarit R G dhe Sh G dhe atë ndrydhje dhe gërvishetje te indeve te buta te regionit e kokës.

Me këtë ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovë.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 41, 43, 45, 73, 74 KP si dhe 359 par. 1 dhe 2 dhe neni 378 paragrafi 6 lidhur me par. 1 te KPK-së, i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Duke i vërtetur dënimin me burgim prej 2 (dy) muajve, si i cili dënim nuk do te ekzekutohen nëse në kohën e verifikimit prej një viti i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I akuzuari lirohet prej shpenzimeve te procedurës konform nenit 453 par. 4 te KPP-ës.

I dëmtuari: B I K nga fsh. S Komuna Suhareke, R M G nga Suhareka rr. “J K” pa numër, Sh R G nga fsh. M Komuna Suhareke, udhëzohen qe kërkesën pasurore-juridike, ta realizojnë ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

PTH. nga Prizreni me aktakuzën I.S. G, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 i Kodit Penal, aktakuzën të cilën gjate shqyrtimit fillestar e ka përfaqësuar, PTH ne Prizren Beqe Shala, i cili në tërësi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarit i cili ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP, ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarit nga ana e PTH ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestar nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hudhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 i Kodit Penal, andaj Gjykata ka vendosur te akuzuarin ta shpall fajtor dhe t’ia shqiptoi dënimin si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Gjykata gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ka vlerësuar te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 te KP, te cilat ndikojnë ne lartësinë e dënimit.

Gjykata si rrethane lehtësuese mori për baze se i akuzuari ka pasur qëndrim korrekt ndaj Gjykatës, ka pranuar fajësinë ne mënyrë vullnetare, është penduar për veprën penale të kryer, është hera e pare qe bie ndesh me ligjin, kurse rrethana posaçërisht renduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës e mori ne kuptim te nenit 452 par.1 te KPP.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKE

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.